



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1132 Prot.
10

Pogradec, më 23. 03. 2023

VENDIM

Nr. 31 DATË 21. 03. 2023

PËR

MIRATIMIN E, LISTËS SË FONDIT KULLOSOR, QË MUND TË JEPEN ME QERA, PËR KULLOTJE E KOSITJE BARI, ME SIPËRFAQE PREJ 1512,75 HA, NË EKONOMITË KULLOSORE; "GOLIK-KALIVAÇ", "VËRRI-DEBROVË", "PRETUSHË-LIN", "GURI TOP-GJEMTH", "DUNICË-LLËNGË" DHE "NIÇË-VALAMARË", DHE KONTRATËS TIP .

Në mbështetje të; nenit 8, shkronjës "c" të pikës 1.2 të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, shkronjës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 15 të Ligjit Nr.9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kullorosor", i ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime ne vendimin Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave e bashkive", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.632, datë 11.06.2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje" si dhe të Udhëzimit Nr. 2, datë 20.07.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e fondit kullorosor, që mund të jepen me qera, për kullotje e kositje bari, me sipërfaqe prej 1512,75 Ha, të ndodhura në ekonomitë kullosore; "Golik - Kalivaç", "Vërrri - Debrovë", "Pretushë - Lin", "Guri Top - Gjemth", "Dunicë - Llëngë" dhe "Niçë - Valamarë", bashkëlidhur dhe pjesë përbërse e këtij vendimi.
2. Të miratojë kontratën TIP të qerasë, për dhënien e kullotave, për kullotje e kositje bari, për një periudhë **1-3 vjecare**, sipas tekstit lidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërse e tij.



3. Për vazhdimin e procedurave të parashikuara nga Udhëzimi Nr.2, datë 20.07.2016 të Ministrit të Mjedisit të ngarkohet Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike pranë bashkisë Pogradec dhe për nënshkrimin e kontratës autorizohet Drejtori i saj.
4. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.
5. U shpall sot më datë ____. ____.2023.

KRYETAR I KËSHILLIT

Sotirag MANGËRI

